



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.570/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bardhyl Topallit, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa parashtruara nga Bardhyl Topallit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik AKR, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me shenjë ZL.Anr.570/2017 e datës 09.11.2017, të parashtruar kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it me datën 09.11.2017, në ora 12:00, ka pranuar një ankesë nga Bardhyl Topalli, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me të cilën thekson se me rastin e procesit zgjedhorë, në cilësinë e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Ferizaj kamë garuar me numër 4, prandaj edhe dyshoj në manipulimin e votave që mu janë bërë në këto Qendra të Votimit . PZAP-it i ka kërkuar që të hapë kutitë në këto qendra të votimit, pasi që ka pasur keqpërdorime të votave në këto Qendra të Votimit QV nr. 2507D/01R, 2507D/02R, 2507D/03R, 2507D/04R, 2507D/05R, 2507D/06D, 2512D/01R, 2512D//02R, 2517D/01R, 2522D/01R, 2522D/02D, 2523D/01R, 2524D/01R, 2524D/02D, 2525D/01R, 2525D/02D, 2533D/01D, 2534D/01R, 2534D/02D.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli i PZAP-it, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi të qartë dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesë, të paraparë me dispozitën e nenit 117 par. 3 të LZP-së ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara në fakte andaj si të tillë ankesën e refuzoj.

Paneli konstaton se ankesa e ankuesit nuk i plotëson këto standarde ligjore. Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë bindëse dhe nuk e ka specifikuar qartë se sa vota i mungojnë në secilën Qendër të Votimit për të vërtetuar pretendimet ankimore lidhur me keqpërdorimin e votave në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të dispozitave të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, Paneli i PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL. Anr.570/2017 më datën 10.11.2017.



Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.